

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-63/14

Prishtinë, 14 qershor 2016

Në çështjen juridike të:

M.R.

Bulevari JNA 120

Beograd-Vozhdovac

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

Pala përgjegjëse në kërkesë-ankesë

Nuk ka

Kolegji i Apelit i AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nurrdini, Kryetare e Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krasimir Mazgalov, anëtarë , duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013 (lënda Je regjistruar në AKP me numrat(KPA90647), i datës 11 qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur me 14 Korrik 2016, morri këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohen si e pabazuar ankesa e M.R. e paraqitura kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013 (lënda Je regjistruar në AKP me numrat(KPA90647), i datës 11 qershor 2013.
2. Vërtetohet vendimi i të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013 (lënda Je regjistruar në AKP me numrat(KPA90647), i datës 11 qershor 2013.

3. Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 21 nëntor 2006 M.R. në Agjencinë Kosovare të Pronës në Prishtinë ,ka paraqitur një kërkesë në emër të babait të tije për njohjen e drejtës së pronës private duke pretenduar se ai është titullar i së drejtës së pronës të paluajtshme që janë objekt i kërkesës, me kërkesë për riposedimin e tyre. Kërkesa është e regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës KPA 90647 që i referohen ngastrës kadastrale 333 dhe 334 të Zonës kadastrale Çikëtove e re të Komunës së Glllogocit
2. Me këtë kërkesa ai pretendon se të drejtat pronësore në ato paluajtshmëri nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave drejtpërdrejtë të ndërlidhura ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999.
3. Për t'i mbështetur kërkesat e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP dokumentet-provat e mëposhtme si:
 - Certifikatë e Arkivit të Serbisë 05 nr.3/230 i dt.29 12.1997 ku theksohet se ky arkiv posedon të gjitha dokumente përkatëse për reformën agrare dhe kolonizimin e viteve 1918-1941 si dhe viteve 19415-1948,ku në mes tjerash është përfshi edhe babai i paraqitësit të kërkesës.
 - Certifikata e lindjes nr.647/200 i dt.12 maj 1995 të lëshuar nga organi kompetent i Komunës Glllogocit, me të cilën konstatohet se titullari së drejtës së pronës së kërkuar ka lindur me 03.03 1937.
 - Letër njoftimin e titullarit të së drejtës pronësore të organi kompetent me dt. 17 shtator 2001 .
4. Sekretaria e AKP ka sigurua zyrtarisht edhe Ekstraktin nga flet posedimi nr.168 i dt.10 mars 2009 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Glllogocit, ku

konstatohet se ngastrat që janë objekt i kërkesës janë të regjistruara si pronë shoqërore të Organizatës punuese “ Agroprodukt “ nga Glllogoci.

5. Në vitin 2010 , Ekipi i notifikimit dhe publikimit ka dalë në vend ku supozoheshin që gjendeshin pronat e kërkuara dhe janë vendosur lajmërimi përkatëse në ngastrës kadastrale duke u bërë edhe ri notifikimi me publikim në gazetën e notifikimit të KPA.
6. Komisioni për kërkesa pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin grupor KPCC/D/A/204/2013 i datës 11 qershor 2013 i ka hedhur kërkesat e palëve si të palejueshme për shkak të mungesës së juridiksionit.
7. Në arsyetimin e këtij vendimi që i referohen kërkesës të regjistruara në KPA 90647 se sipas ekstraktin nga flet posedimi nr.168 i dt.10 mars 2009 të lëshuar nga Drejtoria për kadastër gjeodezi dhe pronësi të Komunës së Glllogocit ku konstatohet se ngastrat që janë objekt i kërkesës janë të regjistruara si pronë shoqërore të Organizatës punuese “ Agroprodukt “ nga Glllogoci. Kjo fletë poseduese sipas raportit të verifikimit të Agjencisë Kosovare të Pronës është vlerësuar pozitivisht.
8. Duke pasur parasysh se prona e paluajtshme është pronë shoqërore dhe paraqitësi i kërkesës këto prona i ka humbur në vitin 1941,atëherë në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin L-03-079 (në tekstin e mëtejshëm Ligji) kërkesa e tij është hedhur për shkak të mungesës së juridiksionit .
9. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 15 nëntor 2013 ndërkaq, i njëjti ka paraqitur ankesë më 16 dhjetor 2013.

Pretendimet e palëve

10. Pala ankuese vendimin ankimor e kundërshton për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe gabimeve procedurale të përfshira në këtë vendim. Në ankesën e tij ai pretendon se ,sipërfaqja e tokës së uzurpuar është më e madhe se ajo që është kërkuar . Ky uzurpim ka ndodhur në vitin 1941 dhe se jeni të detyruar të ma kompozoni dëmin nga viti 141 e këtëj. Lidhur me këtë kërkesë është informuar edhe kryetari i SH.B.A. Barak O Bama.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesave:

11. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.

12. Në rastin konkret vendimi i KKKP-ës i është dorëzuar ankuesit me datë 15 nëntor 2013 ndërkaq, i njëjti ka paraqitur ankesë më 16 dhjetor 2013.
13. Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit ligjor, por njëjta është e pabazuar

Meritat:

14. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, në bazë të dokumentacionit të siguruar nga paraqitësi i kërkesës ,pretendimeve të theksuara në ankesë, provave të siguruara zyrtarisht rezulton se, vendimi ankimor është marr me vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural, kur ka vendosur në vendimin ankimor që kërkesa e regjistruara në AKP nr.90647, duhet të hedhen poshtë si të palejueshme për shkak se ai ka dështuar të paraqet fakte juridikisht të vlefshme dhe të tregojë prova valide se jo vetëm që është pronar i atyre prona të paluajtshme që është objekt i kërkesës por edhe që humbja e tyre ka ndodhur për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur.
15. Përpos kësaj,paraqitësi i kërkesës vet e konfirmon se posedimin e këtyre pronave nuk e kanë pasur nga viti 1941 e këndej dhe se në vitin 1970 janë larguar nga Kosova. E pohon faktin se,humbja e posedimit të këtyre ngastrave kadastrale nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur dhe se as që është humbur posedimi i pronave si pasojë e konfliktit. Për këtë shkak dhe arsye, vendimi i KPCC është i drejtë dhe i ligjshëm kur është vendosur që kërkesa e tillë nuk është në kuadër të mandatit të Komisionit prandaj dhe rrjedhimisht ajo është hedhur.
16. Përpos kësaj paraqitësi i kërkesës vet e konfirmon se posedimin e këtyre pronave nuk e kanë pasur nga viti 1941 e këndej dhe se në vitin 1970 janë larguar nga Kosova. E pohon faktin se humbja e posedimit të këtyre ngastrave kadastrale nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur dhe se as që është humbur posedimi i pronave si pasojë e konfliktit.
17. Rrjedhimisht më të sipërmen mbi bazën e provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara pa mëdyshje mund të konkludohet se drejt është zbatuar dispozita e nenit 3.1 të Ligjit kur është hedhë kërkesa e paraqitësit të tyre në mungesë të juridiksionit. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se Gjykata Supreme ka jurisdikcion në rastet kur të drejtat pronësore nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që lidhen direkt ose që janë rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur mbrenda periudhës kohore midis 27 shkurt dhe qershor 1999. Në rastin konkret, mepamëdyshje dhe në mënyrë të sigurt rezulton se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar për shkak të rethanave që ndërlidhen drejtpërdrejt apo që rezultojnë nga konflikti I armatosur I viti 1998/99,ndaj ajo kërkesë është hedhur,për mungesë të juridiksionit.

18. Nga sa arsyet e paraqitura e me zbatim të dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u refuzua ankesa si e pabazuar duke u vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

19. Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit,

Rolandus Bruin, Gjyqtare e EULEX-it

Krasimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Regjistruer i EULEX-it